



Komuna Suharekë
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA E SUVA REKËS - OPSTINA SUHAREKË REPUBLIC OF KOSOVO - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
27.06.24			
MARRE NE DOREZIM - PRIMIENO - RECEIVED			
Nënda Org. Org. Jeshile Org. Unit	Numit Baj Number	Shifra Prillog Approxok	Vlera Vlergost Value
01	052	34832	-

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT PËR PERIUDHEN JANAR – QERSHOR 2024

Email: [bali.muhammaj@rks-gov.net]

Website: [https://kk.rks-gov.net/suhareke/]

Përmbajtja

1. DREJTORIA PËR BUJQËSI ZHVILLIM RURAL DHE PYLLTARI
2. DREJTORIA PËR EKONOMI BUXHET HE FINANCA
3. DREJTORIA PËR ARSIM
4. DREJTORIA PËR INSPEKSION
5. DREJTORIA PËR ADMINISTRATË
6. DREJTORIA PËR URBANIZËM PLANIFIKIM DHE MJEDIS
7. DREJTORIA PËR SHËRBIME PRONSORE-JURIDIKE DHE KADASTER
8. DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË
9. DREJTORIA PËR KULTURË RINI SPORT DHE MËRGATË
10. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE



HYRJE

Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 dhe Statutin e Komunës së Suharekë, kemi kënaqësinë të paraqesim para jush raportin gjashtëmuor për punët, angazhimet dhe të arriturat e Komunës së Suharekës për periudhen Janar – Qershor 2024.

Qeverisja komunale do të jetë e përgjegjshme para të gjithë qytetarëve duke raportuar dhe duke marrë për bazë gjithmonë kërkesat dhe rekomandimet tuaj në gjitha segmentet e jetës sociale, ekonomike, kulturore, sportive, artistike dhe politike.

Është punuar në projekte infrastrukturore, në aktivitete sportive, në aktivitete kulturore dhe janë takuar organizata publike, private, joqeveritare e ndërkombetare të cilat do te fasilitojnë në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve.

Në raportin gjashtëmuor për periudhen Janar – Qershor 2024, do të shihini te gjitha aktivitetet e drejtorive komunale në Komunën e Suharekës dhe për konceptin e menaxhimit tonë.

DREJTORIA PËR BUJQËSI ZHVILLIM RURAL DHE PYLLTARI

Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari gjatë gjashtëmujorit të parë ka realizuar aktivitete dhe punë të shumta të ndara sipas sektoreve të Drejtorisë.

Nga Janari viti 2024 Sektori i Pylltarisë i cili ka qenë sektor brenda Drejtorisë së Bujqësisë ka kaluar në kaudër dhe përgjegjësisë së Agjencionit të Pyjeve të Kosovës. Poashtu edhe stafi që ka qenë kuadër të Drejtorisë ka kaluar në Agjencion të Pyjeve. Kemi inicuar të gjitha procedurat tenderuese për projektet kapitale që janë të planifikuara në buxhet të realizohen për vitin 2024. Projekte kapitale që janë në realizim e sipër janë

1. Ndërtimi i infrastrukturës rrugore për Bujqësi dhe Pylltari.
2. Ndërtimi i Serave për fermerë, ku aktualisht ky projekt është në realizim e sipër.
3. Asfaltimi i rrugës në bjeshkë të Vraniqit, tek ky projekt jemi në fazën e fillimit të punimeve pasi është nënshkruar kontrata me Operatorin Ekonomik. Projekt tjetër kapital i Drejtorisë që është në fazën tenderuese: Ndërtimi i sistemit të ujitjes së sipërfaqeve bujqësore në Komunë. Fillimi i punimeve pritet të realizohet në muajin Korrik.

NDËRTIMI I SISTEMIT TË UJITJES SË SIPËRFAQEVE BUJQËSORE

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural këtë vit do ta financoj projektin për Ndërtimin e sistemit të ujitjes së sipërfaqeve bujqësore në Komunën e Suharekës, në vlerë prej rreth 300,000.00 €. Në si Dejtori kemi dorëzuar projektin kryesor në Ministri dhe është realizuar marrveshja e Memorandum Bashkpunimit në mes Komunës së Suharekës dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Sipas marrveshjes Komuna e Suharekës inicon procedurën tenderuese dhe se aktualisht ky projekt është në fazën e tenderimit. Ky projekt pritet të fillojë realizimin në muajin Korrik.

Projekti do të realizohet në tre lokacione në fshatrat Vraniq, Studenqan dhe Mushtisht.

Sipas projektit do realizohen rreth 6000 metra.

Ndërtimi i Serave për fermerë

Tek ky projekt kemi përfunduar thirrjen për aplikim ku kanë aplikuar mbi 300 fermerë. Projekt ka filluar të zbatohet në terren ku janë rreth 100 fermerë përfitues me sipërfaqe të përgjithshme prej 1.5 ha me sera. Ky fillimisht janë ndërtuar Serat me sipërfaqe prej 500m² dhe 200m² si dhe tani aktualisht është duke u bërë ndërtimi i atyre me 100 m². Ky projekt pritet të përfundojë në muajin Korrik.

TRAJTIMI I QENEVE ENDACAK

Trajtimi i qeneve endacak është në kuadër të përgjegjësisë së Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, ku këtë vit kemi zhvilluar procedurat e prokurimit dhe kemi nënshkruar kontratën për trajtimin e qeneve endacak sipas procedurave dhe ligjeve në fuqi. Aktualisht Operatori Ekonomik është në fazën realizimit të kontratës sipas planit dinamik të paraparë në kontratë. Deri më tani kemi trajtuar mbi 200 qenë endacak sipas procedurave dhe ligjeve në fuqi.

SUBVENCIONIMI I QUMSHTIT

Në kuadër të projektetve të realizuar me Subvencione si Drejtori për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, jemi duke e bërë subvencionimin e qumshtit me 0.03 cent për fermerët blegoral.

Në këtë 6 muaj, kemi hapur thirrjen për aplikim për subvencionim të qumshtit për 6 muajin e 2-të të vitit 2023, ku kanë aplikuar gjithsej 63 fermerë dhe të gjithë nga këta kanë plotësuar kriteret dhe kanë përfituar nga ky subvencionim i Drejtorisë për BZHRP. Subvencionim i qumshtit do të vazhdojë pas muajit qershor hapim thirrjen për 6 muajin e parë të vitit 2024.

SUBVENCIONIMI I SIPERVAQEVE ME ARRA

Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, në kuadër të programit për zhvillimin e bujqësisë për vitin 2024, ka paraparë të mbështes sektorin e pemtarisë - kulturen e arrës dhe lajthisë përmes subvencionimit me 300 € për ha. Ka përfunduar faza e aplikimit për fermerë sipas Thirrjes Publike, ku kanë aplikuar 70 fermerë. Komisioni i Drejtrisë është në fazën e vlerimit të aplikacioneve. Ky projekt pritet të përfundoj gjatë muajit Korrik.

SUBVENCIONET – Pagesat Direkte të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari ka përfunduar me sukses fazën e fazën e aplikimit për Pagesa Direkte – Subvencione nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Numri i fermerëve aplikues ka arritur në 1237. Si Drejtori në mënyrë që asnjë fermerë të mos mbetet pa aplikuar, kemi punuar edhe pas orarit të rregullt si dhe vikendeve.

Kemi pasur vizita në teren në shumicën e fshatrave të Komunës së Suharekës.

Vizitë në teren në: Njëpërbisht, Budakovë, Sallagrazhdë, Samadraxhë, Studençan, Peqan, Leshan, Reshtan, Maqitevë, Sllapuzhan, Mohlan, Suharekë, Gjinoc, Krushicë, Greikoc, Savrovë, Reqan si dhe shumicën e fshatrave të Suharekës. Stafi i drejtorisë ka dalë në teren ku ka pasur kërkesa për vlerim të dëmeve dhe ka bërë raporte të detajuar vërtetë prej dëmeve që ka hasur në teren. Gjithashtu kemi pasur takime me organizata të ndryshme edhe vendore edhe ndërkombëtare. Takim me Shoqatën e Gjahtarëve “Theranda”. Vizitë në Rahovec tek Departamenti i Vreshtarisë dhe Verarisë të Ministrisë së Bujqësisë.

SEKTORI PËR ZHVILLIM RURAL

Dërgimi i flet paraqitjeve të rrushit të fermerëve në Rahovec 110 fletëparaqitje të shitjes së rrushit. Regjistrimi i 90 fermerëve në regjistrin e fermerëve. Përgatitja e flet aplikacioneve për aplikim në projektet e bujqësisë. Vlerësim dëmeve të 38 fermerëve për dëme të ndryshme. Pritje në zyrë e 250 fermerëve për nevoja të ndryshme, të interesuar për subvencione dhe grante të komunës. Vizita në teren të fermerët pëmtarë dhe udhëzime për krasitje. Lëshimii vërtetimeve për viza për 10 fermer. Trajnim në Rahovec në institutin e Verarisë dhe Vreshtarisë, për sëmundjen “FLAVUSHENCA E ARTE”. 30 vizita në teren për vlerësim të dëmeve në bletari dhe perim – kulturë. Vizitë këshilluese në fshatin Buskosh, Sllapuzhan, Peqan, Sopijsë, Mushtisht, Samadraxhë Vraniq, Studençan në serë për dezinfektim të tyre. Pritje në zyrë e 20 fermerëve për problem me vreshta. Vizitë këshilluese në krasitje të kulturës së arrës në disa fshatra të Suharekës. Vizita këshilluese në fshatin Sallagrazhd të kopshtaritë që gjenden në Suharekë. Vizitë vlerësuese të dëmeve në bletari në fshatin Studençan të fermeri Dorontina Bytyqi. Regjistrimi i 8 fermerëve në regjistrin e fermerëve të Kosovës. Vlerësimi i dëmeve të fermerëve në fshatrat : Njëpërbisht, Studençan, Sopijsë dhe Breshanc, 40 fermer të vizituar. Këshilla për fermer në zyrë për plehërim të grurit 50 fermer. Vlerësim dëmeve në fshatrat Krushicë Eperme dhe fidanishte të bimëve dekorative “Fidanishtja Abazi”. Përgatitja e një materiali të kërkuar nga Ministria Bujqësisë për formën apo mënyrën e vlerësimit të dëmeve nga komisioni komunal.

SEKTORI I BLEGTORISË

Hartimi i planit të punës për Bujqësi dhe Blegtori. Vlerësimi i dëmeve të shkaktuar nga fatkeqësit natyrore në blegtori. Plotësimi i aplikacioneve të fermerëve për subvencionimin e cilësisë së qumshutit dhe viqave për majmeri, ku kanë aplikuar 42 blegtor. Në bazë të ankesave të qytetarëve për trajtimin e qenve endacak në bashkëpunim me ambulancën veterinarë është marr aksion për trajtim. Vizita në teren të fermerëve në bujqësi, blegtori, ku janë vizituar 120 fermer blegtoral. Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të bujqëve gjatë muajve, Janar, Shkurt dhe Mars, Prill, Maj dhe Qershor. Këshillime me fermer dhe udhëzime për subvencione për bujqësi. Plotësimi i formularëve CPO - kërkesat për zotimin e mjeteve financiare në DBZHRP.

DREJTORIA PËR EKONOMI BUXHET DHE FINANCA

Sektori për Ekonomi, Buxhet dhe Financa;

- Janë faturuar **3038** biznese me vlerë prej: **611,472.25 €**.
- Gjithashtu janë faturuar **142** shrytëzues të pronës komunale në vlerë prej: **167,894.86 €**.
- Gjatë kësaj periudhe janë aprovuar **135** kërkesa për zbritje të Taksës në Aktivitet ku vlera stornuar është: **67,807.07 €**.
- Gjatë kësaj periudhe kemi dërguar gjithësej **32** vërejtje të fundit për borgjet e akumuluar të shfrytëzuesve të pronave komunale (rentë dhe qera).
- Gjatë kësaj periudhe janë lëshuar **7379** fletëpagesa për regjistrim të automjeteve ku **179** fletëpagesa janë të liruara ndërsa vlera totale e pagesave është: **76,832.00 €**.
- Janë lëshuar **160** vërtetime dhe **39** çertifikata të ndryshme nga zyrtarët për shërbime të qytetarëve.
- Ne Qendrën e regjistrimit të biznesit deri me datë 25.06.2024 janë regjistruar **135** biznese prej të cilave **49** janë Biznese Individuale dhe **86** janë SH.P.K.
- Në këtë periudhë janë shuar **23** biznese, **2** biznese janë transferuar si dhe janë realizuar **288** modifikime.

Zyra për Regjistrimin e Pasurisë;

- Totali i regjistrimit të pasurisë deri me datë 25.06.2024 është 344,156,853.02€ i pasurive kapitale ndërsa i pasurive jo kapitale (vlera nën 1000.00 €) është 2,949,711.09 €.

Zyra e Thesarit;

- Nga fillimi i vitit deri më 25.06.2024 janë Çertifikuar dhe Aprovuar 2381 lëndë dhe 1,473,452.42 € pagesa nga të gjitha programet e Komunës së Suharekës.
- Të gjitha këto pagesa, pas Çertifikimit dhe Aprovimit janë sistemuar në 33 regjistrator dhe janë arkivuar në Arkivin Financiar të KK në Suharekë.

Sektori i Tatimit në Pronë;

- Janë faturuar dhe dërguar tek tatimpaguesit 9887 fatura të T.PR. me vlerë prej: 885,256.00 €.
- Të hyrat nga Tatimi në Pronë (objekte dhe toka) deri me 25.06.2024 janë: 300,601.75 €.
- Janë bërë rreth 818 inspektime në teren ku gjatë këtyre inspektimeve janë regjistruar 397 objekte të reja, 130 objekte janë paisur me fotografi dhe 129 ndryshime (modifikime) të objekteve. Inspektimet janë realizuar në fshatrat Njëpërbisht, Tërrnje, Gelancë dhe Greikoc.
- Gjithashtu janë lëshuar edhe 233 çertifikata për QPS.
- Gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar 327 ankesa të tatimpaguesve në të gjithë territorin e Komunës së Suharekës.

Të hyrat vetanake të realizuara deri me datë: 25/06/2024

- Të hyrat nga Tatimi në Pronë:-----**300.701.75 €**

• Të hyrat nga Taksa në Aktivitet:-----119,681.68 €

• Të hyrat nga Renta dhe Qeraja:-----75,841.72 €

Emërtimi i Të Hyrave	Buxheti i Alokuar	%	Buxheti i Shpenzuar	%	%
1	2	3	4	5	7=(5:3)
Paga & Shtesa	7,169,936.11	38.87%	6,212,718.86	67.28%	86.65%
Mallra & Shërbime	2,880,905.27	15.62%	967,726.02	10.48%	33.59%
Shpenzime Komunale	597,519.34	3.24%	166,540.55	1.80%	27.87%
Subvencione & Transfere	982,596.70	5.33%	347,166.68	3.76%	35.33%
Investime Kapitale	6,814,195.50	36.94%	1,540,434.07	16.68%	22.61%
Totali:	18,445,152.92	100%	9,234,586.18	100%	50.07%

• Të hyrat nga taksa e regjistrimit të automjeteve: -----76,832.00 €

• Totali i përgjithshme i realizimit të hyrave vetanake: ----- 573,057.15 €

DREJTORIA PËR ARSIM

PLANIFIKIMI I OBJEKTIVAVE TE DKA-së PËR PERIUDHEN JANAR-QERSHOR 2024

Gjatë periudhës tremujore Drejtoria e Arsimit kishte për qellim realizimin e objektivave të përcaktuara në planin vjetor të punës për vitin 2024 të cilat janë të mbështetura në objektivat kombëtare dhe strategjike të MASHTI si dhe objektivat komunale në PZHK të DKA-së të miratuar nga Asambleja Komunale të cilat janë shndërruara në detyra konkrete siç janë:

- Ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie në të gjitha shkollat
- Ngritjen e suksesit të nxënësve dhe rritjen e nivelit të vijueshmërisë së nxënësve në procesin edukativo-arsimor.
- Realizimin e plan-programeve mësimore sipas fushave të KKK
- Plotësimin e kuadrit arsimor përmes konkurseve publike
- Vlerësimin e performancës së drejtorëve/zv.drejtorëve të shkollave .
- Menaxhimi i sigurisë në të gjitha nivelet e arsimit dhe në të gjitha institucionet edukativo- arsimore.
- Sigurimi i mjeteve mbrojtëse-higjenike për kujdesin dhe ruajtjen e shëndetit të nxënësve në të gjitha institucionet edukativo-arsimore të komunës sonë
- Përgatitjet për organizimin e vlerësimeve të njohurive të nxënësve kombëtare : Testi i arritshmerisë – kl.9 dhe testi i maturës- kl.12 dhe vlerësimeve ndërkombëtare : TIMSS –kl. V, TALIS- kl (6-9) dhe ICILLS –(kl 7.) ,garave dhe aktiviteteve për nxënësit e të gjitha niveleve te shkollimit me qellim te motivimit të nxënësve dhe mësimdhënësve për ngritje të cilësisë në arsim.

- Rregullimin, pastrimin dhe mirëmbajtjen e ambientit të brendshme dhe të jashtëm të shkollave

Funksionimi i 29 SHFMU me paralele të ndara , 3 SHML si dhe institucioni parashkollor –çerdhja e fëmijëve “Flutura” me 6 (gjashtë) paralele të ndara në Duhël, Mushtisht, Sopijë, Gjinoc, Studenqan dhe Samadraxhë krijon kushte optimale për mbarëvajtjen e procesit edukativo- arsimor. Si dhe organizimit të mësimin në një ndërrim në : 22 SHFMU si shkolla amë me paralele të ndara fizike dhe SHML “A. Ramaj” në Shirokë.

Numri i nxënësve në të gjitha nivelet e arsimit në komunën tonë

Planifikimi i numrit të nxënësve dhe paraleleve për vitin shkollor 2023/2024 është bërë në mbështetje të UA nr. 03/2022 për regjistrimin e fëmijëve në institucione parashkollore dhe UA nr. 09 /2023-Regjistrimi i nxënësve në klasën e parë të MASHT si dhe në bashkëpunim me shkollat fillore janë planifikuar dhe janë regjistruar nxënësit në klasat e para dhe çerdhen “Flutura” Suharekë. Ndërsa planifikimi dhe regjistrimi i nxënësve në shkollat e mesme të larta është realizuar në bashkëpunim me MASHTI dhe SHML sipas kërkesave të tregut të punës në komunën tonë.

- ❖ Për vitin shkollor 2023/2024 numri i nxënësve është 8788 (duke përfshirë edhe çerdhen “Flutura” në Suharekë). Në krahasim me vitin shkollor 2022/23 numri i nxënësve është zvogëluar për 413 nxënës. Vlen të theksohet se zvogëlim të numrit të nxënësve ka në të gjitha shkollat rurale kurse rritje në ato urbane.
- ❖ Në çerdhen e fëmijëve janë të regjistruar 199 fëmije
- ❖ Në nivelin I-IX janë regjistruar 6686 nxënës të shpërndarë në 453 paralele.
- ❖ Në nivelin X-XIII janë regjistruar 1903 nxënës të shpërndarë në 101 paralele

Nr.	Shkollat	Nxënës të regjistruar		
		F	M	Gjithsej
1	Gjimnazi“ JETA E RE”	140	71	211
2	IAAP “ Skënder Luarasi”	60	192	252
3	IAAP “ Abdyl Ramaj”	118	99	217

Suksesi dhe vijimi i nxënësve në vitin mësimor 2023/2024:Për ndryshim nga vitet e kaluara, MASHTI me UA 21/2023-Kalendari për vitin shkollor 2023/2024 është organizuar në dy gjysmëvjetor :- Gjysmëvjetori i parë me 1.09.2023- 12.01.2024 dhe - Gjysmëvjetori i dytë 24.01.2024-24.06.2024.**Suksesi i nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2023/2024.**Sipas raporteve të shkollave dhe të dhënave të paraqitura në sistemin SMIA të MASHTI suksesi dhe vijueshmëria e nxënësve është i kënaqshëm. Ndërsa nga konsultat me drejtorë të shkollave si dhe analizës së situatës mund të konstatojmë se mbarëvajtja e mësimin të rregullt gjatë kësaj periudhe është realizuar me sukses. Në vazhdim e paraqesim suksesin e nxënësve dhe mungesat për gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2023/2024

Nr	Niveli Arsimor	Shkëlq.	Sh.mire	Mirë	Mjaf.	Me një e më shumë nota të dobëta	Të pa notuar	Gjithsej
1	Arsimi Fillor	2475	1226	1162	348	831	54	6096
2	Arsimi i mesëm	251	411	327	33	868	35	1921
	Gjithsej	2726	1637	1489	381	1699	89	8017

- **Suksesi i paraqitur në formë skematike**



➤ Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kemi zbritje të suksesit (kalueshmërisë) nga 83% në 77.7 %

• **Suksesi i nxënësve në gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor 2024/2025**

Ne këtë periudhë të vlerësimit shkollat janë në proces të përfundimit të vlerësimit të nxënësve.

Kuadri : Në arsimin parafilior, fillor, mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë janë të angazhuar 990 punëtorë, shih tab.

Nr	Programi arsimor	Personeli			Gjithsej personeli 2023/2024
		Mësimdhënës	Personeli administrativ	Personeli mirembajtës	
1	Çerdhja "Flutura" Suhareke	23	3	9	35
2	Shkolla fillore, e mesme e ulët	617	60	93	770
3	Shkolla e mesme e lartë	173	12	24	209
	Gjithsej	813	75	126	1014

Regjistrimi i nxënësve në klasë të dhjetë (10):

Drejtoria Komunale e Arsimit në Suhareke në bashkëpunim me shkollat e mesme të larta, bën planifikimin e profileve, paraleleve, numrin e nxënësve dhe përgatit (shpall) konkurs publik për regjistrimin e nxënësve në klasë të dhjetë (10) për vitin shkollor 2024/2025 në shkollat të cilat janë nën menaxhimin e DKA-së. Planifikimi i regjistrimit të nxënësve në klasë të dhjetë (10) për vitin shkollor 2024/2025 do të bëhet në pajtim me vendimin e MASHTI lidhur me profilet sipas kurrikulës të cilat janë përcjellë për MASHTI.DKA e ka parasysh se do të ketë edhe vështirësi për kuadrin e shkollës këtë vit me rastin e numrit të nxënësve në rënie nga klasa e nëntë (9).

Drejtimit /Profilet e planifikuara për vitin shkollor 2024/2025 në tri shkollat e mesme të larta (SHML)

Komuna	Shkolla	Drejtimi	Nr.i paral	Nr.i nxën
Suharekë	"Jeta e re"	Shkenca natyrore	5	110
		Shkenca shoqërore dhe gjuhësore	4	88

Vlerësimi i jashtëm i njohurive

të nxënësve

(Testi i arritshmërisë-kl. 9, Testi i maturës-12, Testi TALIS –mesimdhënësit e kl 6-9 dhe Testi TIMSS-kl.4-5)

Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëpunim me MASHTI janë në proces të realizimit të vlerësimeve të njohurive të nxënësve pasi i kanë bërë të gjitha përgatitjet për organizimin e vlerësimeve të jashtme të njohurive të nxënësve dhe të vlerësimit të brendshëm të njohurive të nxënësve :

➤ **Vlerësimet e jashtme në nivel vendi :**

-Testi i arritshmërisë – kl.9 dhe

Komuna	Shkolla	Drejtimi	Profili	Nr.i paral.	Nr.i nx.		
Suharekë	"Skender Luarasi"	Teknologji e informacionit dhe komunikimit	Teknik i informatikes se biznesit	1	24		
			Teknik per dizajnim te mediave interaktive	1	24		
			Makineri, prodhim dhe ndertimtari	1	24		
			Instalues elektrik	1	24		
		Art	Instalues i Ngrohjes, Klimatizimit dhe Ujësjiellësit	1	24		
			Automekanik	1	24		
			Mekatronikë	1	24		
			Arkitekturë	1	24		
			Rrobaqepësi	1	24		
		Suharekë/ Shirokë	IAAP "Abdyl Ramaj"	Ekonomi, Administrim dhe Juridik	Nëpunës kontabiliteti dhe i tatimeve	1	20
					Nëpunës për banka dhe sigurime	1	20
					Tregti me pakicë dhe shumicë (Mesim Dual)	1	20
					Asistent Juridik	1	20
Shërbime (Hoteleri - Turizem)	Asistent i mikpritjes hoteliere (Mesim Dual)			1	20		
	Teknologji prodhimi dhe ndertimtari			1	20		
Agrokulturë, Veterinari, Teknologji ushqimore	Laborant i kimisë			1	20		
	Perpunues druri			1	20		
	Mbrojtja e bimëve/Fitofarmaci			1	20		
	Përpunues i ushqimit dhe profes. të ngjashme			1	20		
Shëndeti dhe mirëqenia	Bashkëpunëtor profesional i infermierisë	1	24				
	Asistent dentar (profil i ri)	1	24				

-Testi i maturës- kl.12

➤ **Vlerësimeve ndërkombëtare :**

-Testi TIMSS – Nxënësit e klasave të 5-ta .

-Vlerësimi- TALIS- mësimdhënësit e klasave (6-9)

Testi TIMSS 2024- Eshte realizuar nga MASHTI- Divizionit për Standarde dhe Vlerësim dhe DKA me datë 28 dhe 29 maj 2024 . Këtë vlerësimi iu nënshtruan nxënësit e kl.5 (pesta) të të shkollave të përzgjedhura nga MASHTI e të cilët kanë qenë të përfshirë në këtë test në klasë të 4 gjegjësisht vitin e kaluar -2023: SHF “ 7 Marsi “ Suharekë, SHF” Shkëndija” Suharekë, SHF “ E. Durham” Mushtisht, SHF “D. e Tivarit” Peqan, SHF” V. P. Shkodrani” Leshan dhe SHF’ Dituria” Samadraxhë . DKA i ka bërë të gjitha përgatitjet për organizimin e këtij testi dhe jemi ne pritje të rezultateve të arritura nga nxënësit. **Vlerësimi TALIS 2024** – Është organizuar me mësimdhënësit e ciklit të lartë (Kl.6-9) ne periudhen mars –prill për shkollat e caktuara nga MASHTI . Pyetësorët janë shpërndarë në shkolla dhe linqet ku do të kyqen mësimdhënësit për vlerësim.Shkollat e caktuara për këtë vlerësim jane :SHFMU “ 7 Marsi” ,SHFMU “ Shkëndija”, SHFMU “B. Ndrecaj”, SHFMU “V. P. Shkodrani”, SHFMU“ F. i Arbrit” ,SHFMU “K. I Manastirit” SHFMU “ H. Prishtina “ SHFMU “S. Duhla”, SHFMU “D. e Kombit” SHFMU “ Iliria “ , SHFMU “Sh. Mazreku “. **Testi i arritshmërisë-kl. 9** -Bazuar në vendimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nr. 2/1395 të datës 10.5.2024 Komuna e Suharekës do të organizoi Testin e Arritshmërisë për klasat e IX-ta me datë 25/ 28 .06.2024, DKA i ka bërë të gjitha përgatitjet për organizimin e testi për të gjithë nxënësit e klasave të IX-ta.

Pjesa e parë e vlerësimit –testit të klasave të IX përfundoi sot dhe në të gjitha qendrat e testimit procesi ka shkuar shumë mire ndërsa pjesa e dytë e vlerësimit (testit) mbahet me date 28.06.2024.**Matura 2024** - Sipas vendimit të MASHTI nr. 01B/039 të datës 17.04.2024- dhe bazuar në Ligji mbi Maturën Shtetërore Nr. 05/L-018 ,Matura 2024 është planifikuar të organizohet në dy afate (Qershor dhe Gusht).Shkollat dhe DKA janë angazhuar për të bërë të gjitha përgatitjet për organizimin e testit të maturës duke siguruar hapësirë së përshtatshme, ujë të pijes dhe lapsa (në rast se u mungojnë nxënësve) .Për ndryshim nga viti i kaluar këtë vit aplikimi për paraqitjen e testit ka qenë përmes platformës e-kosova. Bazuar në të dhënat e shkollave, 530 maturantë të rregullt këtë vit e kanë paraqitur **online përmes sistemit e-Kosova** provimit të maturës ndërsa 70 maturant kryesisht të shkollave profesionale nuk e kanë paraqitur provimin e maturës.

Në bazë të raporteve të shkollave Provimit të Maturës shtetërore 2024 iu nënshtruan :

1	Gjimnazi “ Jeta e re”-Suharekë	238 nxënës
2.	IAAP”A. Ramaj” Shirokë	149 nxënës
3	IAAP “ S. Luarasi “ Suhareke	143 nxënës

Testi u realizua në 3 objekte shkollore për katësisht në 4 qendra të testimit, (qendra 1- Gjimnazi “ Jeta e re”, qendra 2-SHFMU “7 Marsi” , qendra 3 dhe 4 ne IAAP “ SkenderLuarasi” Suhareke) .Tani jemi ne pritje të rezultateve të arritura nga nxënësit.

Zhvillimi profesional i mësimdhënësve

Gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore DKA në bashkëpunim me organizatat :- **KosEd –Perkrahje për arsimin fillor dhe të mesëm të lartë** është duke e realizuar projektin “ Vlerësimi i udhëhequr nga kolegët “ në të cilin janë përfshirë 4 shkolla : SHFMU : D. Bajraktari “ Suharekë ,SHFMU “K. i Manastirit” Studenqan, SHFMU” E. Durham”-Mushtisht, dhe SHFMU “ Gj. K. Skenderbeu” Sallagrazhdë .Gjatë realizimit të këtij projekti është zhvilluar bashkëpunimi kolegjial mes shkollave për të monitoruar punën e gjithëmbarshme të shkollave duke filluar nga PZSHH, Plani vjetor , Planet dy mujore ,planet javore dhe ditore të mësimdhënësve duke përfshirë edhe monitorimin kolegjial në orë mësimore si dhe trajnimin e mësimdhënësve.

- **Lionis International-Lionis Club Peja** – Realizoj projektin “Shprehitë e adoleshencës” përmes së cilit janë trajnuar mesimdhënësit e lëndës ed. qytetare ,psikolog të shkollave dhe mesimdhënës të fushave tjera për të cilët janë shpërndarë dhe certifikat .

- **Instituti Pedagogjik i Kosoves (IPK) dhe organizata KosEd** organizuan seminarin me temën : Ngritja e kapaciteteve për rishikim të teksteve shkollore në arsimin e detyrueshëm (0-9).

Pjesëmarrës ishin mësimdhënës të gjimnazit dhe SHFMU të lëndës se: Gjuhës shqipe ,Historisë ,Gjeografisë, Fizikes ,TIK si dhe pedagog /psikolog .Pjesëmarrësit e përfshirë në trajnim, certifikohen me 48 ore pune.

Vizitat e realizuara në shkolla:DKA me qëllim të avancimit të punës në institucionet shkollore ka planifikuar vizitat e rregullta në shkolla për kontrollimin e mbarëvajtjes së procesit edukativo-arsimor,mirëmbajtja e dokumentacionit pedagogjik-administrativ mirëmbajtja e ambientit të brendshëm dhe të jashtëm të shkollës:

1. Kontrollimi dhe marrja e informatave për dokumentacionin pedagogjik
2. Gjendja e objekteve shkollore dhe ambientet e jashtë për krijimin e kushteve të favorshme për nxënës dhe mësimdhënës .
3. Dokumentacioni administrativ: Libri i të punësuarve, Libri i protokollit, Libri i klasave, Procesverbalet, Librat amë etj..
4. Vlerësimi i përfundimit të shkollës dhe PZSHS
5. Plani dhe programi vjetor i punës në shkollë: Planet e drejtorit, planet e aktiveve profesionale, këshillit të mësimdhënësve, këshillit të klasave, planet e aktiviteteve jashtëmësimore etj.
6. Orët e humbura
7. Mjetet mësimore
8. Organizimi i mësimin të rregullt dhe mësimin plotësues.

Për të gjitha shkollat fillore të mesme të ulëta dhe të mesme të larta janë hartuar Procesverbalet e incizimit të gjendjes së bashku me rekomandimet për të eliminuara lëshimet e konstatuara.

Vlerësimi i përfundimit të drejtorëve /zëvendës drejtorëve të shkollave

Në bazë të UA-106/2020, DKA e ka formuar komisionin për vlerësim të performancës së drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave për periudhën e punës katërvjeçare. Komisioni prioritet për vlerësim të përfundimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të cilëve iu përfundonte mandati(kontrata e punës) , e që në këtë periudhë tremujore është vlerësuar performanca e drejtorit të SHFMU "H. Prishtina " në Smetisht ,SHFMU "17 Shkurti" Shirokë dhe çerdhja "Flutura në Suharekë .

Garat, aktivitetet e lira dhe aktivitetet jashtëmësimore

DKA ka përgatit rekomandimet për shkolla për realizimin e aktiviteteve në nivel të shkollave për ngritjen e cilësisë dhe motivimin e nxënësve për punë. Fokusi ka qenë që të gjitha aktivitetet të barten në shkolla në mënyrë që të përfshihen dhe motivohen të gjithë nxënësit pa përjashtim.

Në kuadër të bashkëpunimit me OJQ –të për realizimin e projekteve të miratuara nga MASHT-i, DKA ka organizuar garat në nivel të shkollave dhe garat në nivel komunal .Realizimin e garave komunale në fushën e matematikës dhe fizikes në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe shoqatën e matematikentëve të rinjë dhe shoqatën e fizikantëve

DKA në bashkëpunim me organizatat në nivel vendi organizoi gara dhe aktiviteteve për nxënësit e të gjitha niveleve të shkollimit me qëllim të motivimit të nxënësve dhe mësimdhënësve për ngritje të cilësisë në arsim.

-Gara " Kodimi dhe Robotika"- qëllimi i së cilës ishte të inkurajojë dhe të promovojë interesin dhe aftësitë në fushën e kodimit dhe robotikës në mesin e nxënësve. Kjo gara ofron një platformë për nxënësit për të zhvilluar aftësitë e tyre kreative, teknike dhe inxhinierike duke punuar në projekte të ndryshme në lidhje me kodimin dhe robotikën. Në garën e Kodimit në nivel botëror nga 146 shtete, 3912 shkolla, 8946 klasë dhe 115286 nxënës, në renditimi në vendin e 9 në botë më pjesëmarrjen e nxënësve të talentuar nga dy shkollat SHFMU " 28 Nëntori " Doberdelan dhe SHFMU " Ismet Jashari-Kumanova" Javor me të cilët kemi arritur këtë rezultat. Dita Ndërkombëtare e Matematikës e cila u organizua për herë të parë në komunën e Suharekës. të prezantojnë nga dy projekte të ndryshme:

-Inovacion teknologjik: Disa projekte mund të kenë përdorur teknologji të reja, aplikacione kompjuterike, ose platforma online për të zgjidhur probleme matematikore.

-Modelizimi grafik: Nxënësit mund të kenë përdorur grafika, vizualizime, ose modele për të shpjeguar koncepte matematikore.

-Prezantime kreative: Përfaqësimi i projekteve mund të ketë përfshirë performanca, video, ose materiale të tjera krijuese të personalizuar.

Në fund secilës shkollë iu ndanë certifikata për pjesëmarrje.

Siguria në shkolla: Duke pasur parasysh që nxënësit një pjesë shumë të madhe të kohës e kalojnë në ambientet shkollore, është shumë e rëndësishme jo vetëm për mirëqenien e tyre po edhe për vetë procesin edukativo-arsimor, të ketë siguri të lartë në shkollë. Natyrisht, se janë një sërë faktorësh të cilët ndikojnë në krijimin e bindjeve dhe perceptimeve për sigurinë në shkollë. Prandaj DKA ka marr të gjitha masat për krijimin e një klime sa më të mirë në të gjitha institucionet edukativo- arsimore. Gjatë periudhës vijuese DKA në Suharekë është në fazën e ndërtimit të sallave të edukatës fizike , fushave sportive dhe objekteve të krijimin e kushteve edhe në shkollat tjera për organizimin e mësimin në një ndërrim.

Menaxhimi i objekteve shkollore

Gjatë kësaj periudhe kohor është përcjell gjendja e objekteve shkollore dhe sipas nevojave janë bërë aktivitete të kësaj natyre, si:

- Përgatitja e paramasave për adaptim edhe meremetime në shkolla
- Furnizimi me material zyrtar për administratë dhe shkolla
- Planifikimi dhe mirëmbajtja e ngrohjes qendrore në shkolla
- INVESTIMET KAPITALET- 2024

INVESTIMET KAPITALET- RAPORT 3 MUJOR-2024						Situacionet e paguara-2023					situacionet e paguara 2024			
n r.	kod et	ARSIMI DHE SHKENCA	fondi (10)	fondi (21)	kontrata t	I	II	III	IV	V	Shuma e shpenzimeve per projekte	Mbetjet nga projektet 2 vjeqar	% e shpenzuar e buxheti t	sqarim
1	529 04	Ndërtimi i sallës sportive shfmu GK.K.Skenderbeu" - Salagrazhdë	150,000.00	40,000.00	267,648.92	50,000.00	50,000.00	50,000.00	45,000.00		150,000.00	72,648.92	56%	ne punim
2	523 28	Ndërtimi i sallës sportive shfmu "Naum Veqilharxhi" Mohlan	150,000.00	10,000.00	279,999.97	45,000.00	35,018.50	69,981.50	20,000.00	69,231.40	239,231.40	40,768.57	85%	ne punim
3	523 94	Ndërtimi i sallës sportive shfmu "Shaban Mazreku" Sopijë	45,000.00	40,000.00	268,480.52	45,000.00	50,000.00			40,000.00	135,000.00	173,480.52	50%	ne punim
4	523 96	Ndërtimi i aneksit te objekti SHFMU "Besim Ndrecaj". Maqitevë	101,092.00	50,000.00	251,746.50	20,094.00	-	-	-		20,094.00	231,652.50	8%	ne punim
5	541 76	Ndërtimi i sallës sportive shfmu "V.Fraseri" Bukosh	-	30,000.00									0%	ne tender
TOTALI I BUXHETIT			446,092.00	170,000.00							544,325.40	518,550.51		

- Hartimi i buxhet të DKA-së dhe shkollave për vitin 2025 dhe parashikimi për vitin 2027. Hartimi i buxhetit sipas qarkores buxhetore 202/01 duket si në tabelen:

Institucioni	Paga dhe shtesa	Mallra dhe shërbim	Komunali	Subvencione	Pasurijo financ.	Mallra dhe shërbime nga THV	Shp.Komunale nga THV	Subvencione nga THV	Pasurit jo financiare THV	Gjithsej
DKA	89,738	210,000	0	110,000	800000	180,000	45,000	90,000	100000	1,524,738
Çerdhja	236,674	30,000	5,000	0	0	10,000				281,674
Arsimi Fillor	6,154,009	417,263	70,000	0	62,048	15,000	20,000	0		6,738,320
Arsimi i mesëm	1,746,840	160,000	20,000	0	0	10,000	21,000	0		1,957,840
Gjithsej	8,227,261	817,263	95,000	110,000	862,048	215,000	86,000	90,000	100000	10,602,572

Nga tabela konstatohet se buxheti i hartuar për vitin 2025 është 9,702,572.00€, në të cilin nuk janë përfshirë pasurit jo financiare nga të hyrat vetanake.

- Pas procesit të alokimit në SIMFK nga ana e Thesrit apo aprovimit të "Planit të Keshit" jemi përgjegjës për regjistrimin e nën alokimeve për nivelin e nën programeve nga FB 10 për mallra, shërbime dhe komunali, si në tabelën:

Nr	Niveli Arsitor	Mallra dhe shërbime	Komunali
1	Arsimi Pra Fillor	40,000	6,000
2	Arsimi Fillor	405,652	70,000
3	Arsimi i mesëm	159,000	24,000
Gjithsej		604,652	100,000
Gjithsej nën alokime per 6 mujor		704,652.00	

Procesi i Nën Alokimeve në tërësi është përfunduar për secilën shkollë me anë të formulës për periudhën vjetore 2024.

Konkurset

Në mbështetje të UA nr.15/2019 dhe UA nr.05/2021 dhe UA nr.05/2015– Normativeve të MASHT për pranimin e kuadrit arsimor, janë shpallur:

- Dy (2) Konkurse për mësimdhënës gjithësej janë publikuar pesë pozita dhe janë përfunduar sipas aftit ligjor.

Për të gjitha pozitat është zhvilluar procedure konform UA në fuqi.

Pensionime: Gjatë kësaj periudhe janë pensionuar gjithsej pesë (11) punëtor

Pushime të lehonisë : Gjatë kësaj periudhe në pushim të lehonisë janë tetë (17) punëtorë.

- Përmes intranetit janë pranuar gjithsej **217** lëndë prej tyre të miratuara **111**,refuzuara **79**,në proces **27**.

Takime të rëndësishme të DKA-së

-Takimet e rregullta javore konsultative të drejtorëve komunal me kryetarin e komunës

- Takime pune me inspektorët e arsimit të SIA-së në Prizren

- Takimet zyrtare në MASHT

- Takime me SIA

- Takimet në asamblenë komunale

- Takimet javore me stafin e DKA-së

- Takimet mujore me drejtorët e shkollave.

- Takime të ndryshme me organizata dhe donatorë për realizimin e projekteve për ngritjen e cilësisë në arsim.

Objektivat për periudhën e ardhshëm

- Ngritja e suksesit të nxënësve për periudhën e ardhshme dhe zvogëlimi i numrit të mungesave

- Shpallja e konkursit dhe pranimi i kuadrit në bazë të normativit për pranim të kuadrit.

- Pajisja e shkollave me mjete mësimor.

- Rregullimi dhe meremetimi i objekteve shkollore me prioritet.

- Vizitë- monitorim dhe kontroll sipas planifikimit dhe nevoja të shkollave.

DREJTORIA PËR INSPEKSION

INSPEKTORI KOMUNAL – MJEDISOR

Gjatë këtij 6 Mujori, është përcjellur gjendja e përgjithshme e mjedisit në çështjet komunale në tërë territorin e Komunës së Suharekës, sipas planit përkatës, konform ligjit dhe rregulloreve në fuqi. Inspektorët e ambientit i ka kryer detyrat e punës në kompetenc sipas Ligji Nr. 03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit, Logji për parandalimin dhe luftimin e pandemic Covid-19 Ligji Nr. 07/L-006, Ligjet tjera të lëmisë përkatëse, Udhëzimeve administrative dhe Vendimeve Qeveritare. Gjithashtu është bërë shqyrtimi i të gjithave ankesave të qytetarëve që i përkasin lamisë tonë dhe është vepruar sipas rregullorëve përkatëse. Kanë bashkëpunuar me kolegët inspektor, te tregut, ndërtimtarisë, AUVK dhe Policinë e Kosovës. Gjithashtu kanë bashkëpunuar edhe me qytetarët dhe bizneset për zbatimin e dispozitave Ligjore për të krijuar një ambient të pastër. Kanë bërë kujdestari gjatë vikendeve dhe festive. Është bere aktivitet në bashkëpunim me të gjitha institucionet relevante për pastrimin e hapësirave publike. Pjesëmarrje në disa komisione të ndryshme, caktuar me **aktvendime**.

Gjatë kësaj periudhe, te raportuar nga Inspektoret, janë zhvilluar këto procedura:

• Procesverbale	61
• Kontrollime inspektuese	94
• Urdhëresa për sanim të gjendjes	61
• Aktvendime	47
• Procedura e sipër	45
• Nga vete palet jan kryer	49

• Vizita ne terren nga kerkesa e paleve	48
• Urdhëresa për ekzekutim	2

Gjithashtu janë bërë edhe angazhime shtesë në asistimin e kolegëve në lëmi të ndryshme brenda dhe jashtë Drejtorisë.

INSPEKTORET KOMUNAL I TREGUT

Gjatë kësaj periudhe, inspektori i tregut ka kryer detyrat e punës të parapara me Ligjet e lëmisë përkatëse, Udhëzimeve administrative dhe Vendimeve. Ka bashkëpunuar me kolegë inspektor të Komunës sonë dhe kanë marrë pjesë në aksionet sipas kërkesës nga Ministria e Tregtisë, Industrisë, nga Ministrisë së Punëve të Mbrendëshme dhe ajo për Ekonomi dhe Financa, si për inspektimin e veprimtarive hoteliere, tregtare, furrave të bukës etj. Inspektori ka bashkëpunuar me qytetarë dhe biznese për zbatimin e dispozitave Ligjore për të krijuar një treg konkurent dhe të besueshëm me qëllim të njoftimit të Ligjeve të reja (Vendimet) dhe duke ofruar këshilla të tjera. **Gjatë kësaj periudhe, janë kryer gjithsej:**

• Procesverbale	148
• Gjendje e konstatuar në rregull	25
• Urdhëresa për eliminimi i të metave	28
• Inspektime	55
• Refuzime të pranimeve teknike	41
• Pranime teknike	65
• Aktvendime	56
• Fletparaqitje	0
• Inkasimi i mjeteve nga Pranimi Teknik	3190 Eu.
• Asgjësimi i mallrave	1

INSPEKTORI I NDËRTIMTARISË- KOMUNA SUHAREKË

Gjatë kësaj periudhe, i Inspektori i Ndertimit i kam kryer detyrat e punës në kompetenc sipas LIGJI Nr. 04/L-110 per Ligji për ndertim, Nr 08/L-067 Ligji per Ispektim, Ligjeve tjera të lëmisë përkatëse, Udhëzimeve administrative dhe Vendimeve Qeveritare. Ka bashkëpunuar me koleget inspektor sanitar,tregut, veterinar, ambientit, AVU dhe Policin e Kosovës.Ka bashkëpunuar me qytetarë për të krijuar rregull për organizimin e organeve inspektuese në ndertim si dhe në kompetence të administratës shtetërore dhe komunale.Jane pranuar kërkesa, ankesa të ndryshme për ndertime pa leje dhe ndertimeve me leje si dhe kërkesa për inspektim gjatë ndertimit dhe ju kam përgjegjur me kohë.Jane kryer rrenime me kërkesa të drejtorive komunale të cilat kanë paraqitur rrezikshmeri dhe kanë penguar në realizimin e projekteve të zbatueshme komunale.Inspektimet e bëra janë përcjellur me procesverbal, meqë janë bërë edhe shumë inspektime pa procesverbale.

Gjatë kësaj periudhe, janë kryer gjithsej:

Nr.	Puna	Sasia
1	Procesverbale	53

2	Inspektime	111
3	Konservimi i objekteve me shirit rrethues	0
4	Aktvendime	2
5	Vendime per kundervajtje	2
6	Kerkesa te paleve	34

INSPEKTORI KOMUNAL I KOMUNIKACIONIT

Gjatë kësaj periudhe, inspektori i komunikacionit ka përcjell gjendjen e përgjithshme të komunikacionit rrugorë dhe çështjet tjera në tërë territorin e Komunës së Suharekës, sipas planit përkatës, conform ligjit dhe rregulloreve në fuqi. Gjithashtu është bërë shqyrtimi I të gjitha ankesave të qytetarëve që I përkasin lëmisë së komunikacionit dhe është vepruar sipas rregullorëve përkatëse.

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar këto procedura:

• Procesverbale	39
• Aktvendime apo Pelqime te komunikacionit	15
• Leje pune per Autotaksi	3
• Vizita në teren me kërkesa të palëve	35

Gjithashtu janë bërë edhe angazhime shtesë në asistimin e kolegëve në lëmi të ndryshme brenda Drejtorisë.

DREJTORIA PËR ADMINISTRATË

1. Sektori i Gjendjes Civile

Gjendja Civile është pushtet i deleguar nga niveli qendror, që vepron në kuadër të Komunave ARC/MBP (Agjencia e Regjistrimit Civil/Ministria e Punëve të Brendshme) Sektori i Gjendje Civile lëshon këto dokumente i në vijim: certifikatat e gjendjes civile, regjistrimet e lindjeve, certifikatat e lindjes, certifikata zëvendësuese e lindjes, certifikata e kurorëzimit, certifikatë zëvendësuese e kurorëzimit, certifikatat e vdekjes, certifikatat e vendbanimit, certifikatë e jetës në bashkësi familjar, certifikatat mbi statusin martesore, regjistrimi I fëmijës të gjetur – aktvendimit të qendrës për punë sociale ose aktgjykimit vlershëm, regjistrimet e më vonshme të lindjeve, regjistrimi i fëmijëve të lindur në botën e jashtme, lidhja e martesave- kurorëzimi, kurorëzimi me shtetas të huaj, regjistrimet e martesave të bëra jashtë Kosovës. Në kuadër të Gjendjes Civile janë në funksion dy E-Kioskave për shërbim të qytetarëve 24/7 për dokumentet si: Certifikatë e lindjes, Ekstrakti i Lindjes, Certifikatë e Martesës, Certifikatë e Vendbanimit, Certifikatë e Shtetësisë, Certifikatë e Vdekjes. Prioritet i Drejtorisë për Administratë mbetet ofrimi i shërbimeve në mënyrë korrekt, transparente dhe në kohë sa më të shpejt të mundshëm, për të cilën vlerësojmë që ja kemi arritur.

Për këtë periudhë gjithsej janë lëshuar këto dokumente:

Numri i kërkesave për certifikata të GJC sipas zyrtarit regjistruar

01/01/2024 - 24/06/2024

shyhrete.morina

Pershkrimi	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Totali
Certifikata e lindjes	49	1,376	0	1,425
Certifikata e vendbanimit	4	297	0	301
Certifikata e Shtetësisë	0	15	0	15
Certifikata e vdekjes	9	270	0	279
Certifikata e Martesës	9	386	0	395
Ekstrakti i lindjes	37	2,241	0	2,278
Certifikata e statusit martesor	0	116	0	116
Vërtetim nga arkiva	3	88	0	91
Deklarate e bashkesise familjare	6	213	0	219
	117	5,002	0	5,119

shpresa.h.berisha

Pershkrimi	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Totali
Certifikata e vdekjes	0	225	1	226
Certifikata e Martesës	0	522	2	524
Certifikata e statusit martesor	0	118	1	119
Vërtetim nga arkiva	0	100	1	101
Certifikata e Shtetësisë	0	17	0	17
Ekstrakti i lindjes	0	2,371	5	2,376
Certifikata e vendbanimit	0	302	1	303
Deklarate e bashkesise familjare	0	184	1	185
Certifikata e lindjes	0	1,628	8	1,636
	0	5,467	20	5,487

leotrim.e.berisha

Pershkrimi	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Totali
Certifikata e vdekjes	0	12	0	12
Deklarate e bashkesise familjare	0	9	0	9
Certifikata e statusit martesor	0	6	0	6
Ekstrakti i lindjes	2	67	0	69
Certifikata e vendbanimit	0	6	0	6

Certifikata e Martesës	0	20	0	20
Certifikata e Shtetësisë	0	2	0	2
Certifikata e lindjes	0	43	0	43
	2	165	0	167

fatmir.perzhaku

Pershkrimi	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Totali
Certifikata e vdekjes	0	113	0	113
Certifikata e Martesës	0	338	1	339
Deklarate e bashekesise familjare	0	136	0	136
Certifikata e statusit martesor	0	164	0	164
Ekstrakti i lindjes	0	1,243	1	1,244
Certifikata e vendbanimit	0	137	0	137
Certifikata e Shtetësisë	0	8	0	8
Vërtetim nga arkiva	0	46	0	46
Certifikata e lindjes	0	726	5	731
	0	2,911	7	2,918

alush.q.kabashi

Pershkrimi	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Totali
Ekstrakti i lindjes	0	273	0	273
Certifikata e vdekjes	0	23	0	23
Certifikata e vendbanimit	0	26	0	26
Deklarate e bashekesise familjare	0	28	0	28
Vërtetim nga arkiva	0	3	0	3
Certifikata e statusit martesor	0	8	0	8
Certifikata e lindjes	0	162	0	162
Certifikata e Martesës	0	41	0	41
	0	564	0	564

lumturije.bytyqi

Pershkrimi	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Totali
Vërtetim nga arkiva	0	23	0	23
Certifikata e Martesës	2	439	0	441
Certifikata e statusit martesor	2	277	0	279
Certifikata e vendbanimit	2	133	0	135
Certifikata e Shtetësisë	0	5	0	5
Ekstrakti i lindjes	9	994	0	1,003
Certifikata e lindjes	8	523	0	531
Certifikata e vdekjes	0	46	0	46
Deklarate e bashkekesise familjare	1	117	0	118
	24	2,557	0	2,581

ruzdi.hamiti

Pershkrimi	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Totali
Certifikata e lindjes	106	413	0	519
Certifikata e vdekjes	5	51	0	56
Ekstrakti i lindjes	78	586	0	664
Deklarate e bashkekesise familjare	32	54	0	86
Vërtetim nga arkiva	1	10	0	11
Certifikata e Shtetësisë	1	3	0	4
Certifikata e Martesës	26	171	0	197
Certifikata e statusit martesor	5	41	0	46
Certifikata e vendbanimit	19	61	0	80
	273	1,390	0	1,663

valbona.zymberi

Pershkrimi	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Totali
Certifikata e vendbanimit	0	62	0	62
Certifikata e Martesës	0	122	0	122
Ekstrakti i lindjes	0	620	2	622
Certifikata e lindjes	0	183	0	183
Vërtetim nga arkiva	0	12	0	12
Certifikata e vdekjes	0	72	0	72

Certifikata e Shtetësisë	0	1	0	1
Certifikata e statusit martesor	0	65	1	66
Deklarate e bashkekesise familjare	0	66	0	66
	0	1,203	3	1,206

jeton.h.bytyci

Pershkrimi	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Totali
Deklarate e bashkekesise familjare	0	109	3	112
Certifikata e lindjes	0	747	1	748
Certifikata e vdekjes	0	140	0	140
